struzioni ma delimitato da un diaframma che permette la visuale su un parco di cipressi adiacente. Se i progetti per Elbassan e Valona incarnano due differenti visioni urbane, per tipologia di spazio e per codici compositivi degli edifici, una sintesi viene proposta nella definizione dello spazio centrale sul quale viene concepito il piano regolatore della città di Scutari¹⁵. Il progetto generale per il nuovo assetto del tessuto e della viabilità viene incentrato sulla risoluzione di un problema legato all'attraversabilità ed alla circolazione, prima impedita dal sistema stradale compromesso. All'incrocio di due grandi viali principali, corso Vittorio Emanuele e viale Mussolini, posti in maniera ortogonale tra di loro, si rende necessaria una nuova piazza rappresentativa di una rinnovata immagine urbana, in grado di dialogare sia con le presenze storiche esistenti che con la volontà formale ed estetica del regime.

Bosio, che riceve incarico diretto per la progettazione, fonde attraverso un'alternanza di pieni e vuoti l'identità costruita della città con le nuove architetture, dilatando i confini della piazza oltre i margini costruiti ed impostati dal sistema stradale, fino ad andare a includere nello spazio collettivo una moschea presente nelle immediate

Nëse projektet për Vlorën dhe Elbasanin mishërojnë dy vizione të ndryshme urbane, si nga lloji i hapësirës ashtu edhe nga kodet kompozicionale të ndërtesës, një sintezë e tyre është propozuar në përcaktimin e hapësirës qendrore mbi të cilën është konceptuar plani rregullues i qytetit të Shkodrës¹⁵. Plani i përgjithshëm për rregullimin e ri të strukturës dhe të lëvizshmërisë në rrugë fokusohet në zgjidhjen e problemeve që lidhen me qarkullimin dhe kapërcimin e saj, gjë e cila më parë pengohej nga një sistem rrugor i amortizuar. Në kryqëzimin e dy bulevardeve të mëdha kryesore, Corso Vittorio Emanuele dhe Viale Musolini, të cilët formojnë një kënd të drejtë me njëri-tjetrin, lind nevoja për ndërtimin e një sheshi të ri që do të përfaqësojë një imazh të ripërtëritë urban i cili është në gjendje të komunikojë si me aspektet ekzistuese historike ashtu edhe me vullnetin formal dhe estetik të regjimit.

Bosio, i ngarkuari i drejtpërdrejtë për projektimin, nëpërmjet gërshetimit të hapësirave të mbushura e atyre të zbrazëta shkrin në një identitetin e ndërtuar të qytetit me arkitekturën e re, duke zgjeruar kufijtë e sheshit përtej kufijve tashmë të ndërtuar dhe të ngritur nga sistemi rrugor, duke përfshirë madje në hapësirën kolektive edhe një xhami që ndodhet aty afër. Sheshi i ri merr formën e një vakumi të madh me drejtime të ndryshme të cilat e zhvendosin më shumë se një herë perimetritin i cili mbahet i bashkuar nga një fill i përbashkët; ai duket më i madh se sheshet e menduara për Elbasanin dhe Vlorën dhe i përshtatet në mënyrë proporcionale kryqëzimit të dy bulevardeve të mëdha kryesore të cilat na ofrojnë sistemin referencë të përmasave, duke u larguar kështu nga koncepti i sheshit urban si një vend ku takohen njerëzit dhe duke u shndërruar në një vend ku kremtohet kultura urbane më monumentale. Në Shkodër bashkëjetojnë, si shprehje e një evolucioni të sheshit të Katedrales së Vlorës, identiteti lokal, të cilin Bosio¹⁶ në Shqipëri e përmbysi madje më tepër edhe se në Afrikë, dhe stili i ri italian, të cilët këtu përfaqësohen nga xhamia dhe palati i Bashkisë me një kullë fashiste simbolike. Xhamia bëhet kështu kufiri i ri i sheshit duke

vicinanze. La nuova piazza acquisisce la forma di un ampio vuoto con diverse direttrici che ne spostano a più riprese il perimetro tenuto assieme da un filo comune; essa appare più grande rispetto quelle immaginate per Elbassan e per Valona, e si adegua proporzionalmente all'innesto dei due grandi viali che forniscono il sistema dimensionale di riferimento, allontanandosi concettualmente dalla piazza cittadina come luogo di incontro e divenendo luogo di celebrazione di una cultura urbana più monumentale. A Scutari convivono, come evoluzione della piazza della cattedrale di Valona, l'identità locale, mai stravolta in verità né in Africa quanto in Albania da Bosio¹⁶ e il nuovo linguaggio italiano, rappresentati qui dalla moschea e dal palazzo della Baskija con una simbolica torre arengario. La moschea diviene il nuovo limite della piazza ed imposta una quinta verde, grazie all'intuizione di posizionare una corona di cipressi attorno ad essa, capace di eludere il rapporto visuale e di confronto tra i suoi codici compositivi e le nuove architetture porticate e razionali dei nuovi edifici amministrativi. La cinta di alberi diviene motivo di novità nella composizione della grande piazza, infatti essa porta il tema del verde all'interno di un contesto prevalentemente murato e ne fa un punto di forza, soprattutto in virtù della dimensione fin troppo ampia per potersi considerare una piazza rispetto agli altri interventi proposti dall'Ufficio Centrale. All'interno delle opere progettate nel corso del periodo in cui Bosio è a capo della struttura albanese è ascrivibile una sequenza evolutiva del linguaggio compositivo, se non relativo agli impianti planimetrici degli edifici, sempre impostati su di un rigore funzionale molto discreto, piuttosto relativo ai fronti degli edifici, soprattutto in relazione al rapporto con lo spazio pubblico. Elbassan e Valona parlano lingue diverse: morbido ed in linea con il luogo il primo, monumentale e romano il secondo vagamente tendente allo *stile littorio* romano.

Una sintesi compositiva viene raggiunta con il progetto per la nuova piazza di Coritza¹⁷ con il nuovo edificio della Baskija, che vede la nascita di un insieme di innovazioni linguistiche più raffinate rispetto alle mediazioni operate nei progetti per

krijuar një hapësirë të gjelbër, në sajë të intuitës që pati Bosio për të vendosur një kurorë selvish rreth e rrotull tij, e cila do të shmangte impaktin pamor dhe krahasimin mes kodeve të saj kompozicionale dhe arkitekturës së re me portikë të ndërtesave të reja administrative. Ripi i pemëve të vendosura kthehet në një risi kompozicionale e sheshit të madh, në fakt ajo mbart temën e gjelbërimit brenda një konteksti kryesisht me mure dhe e bën një pikë të fortë, veçanërisht nga pikëpamja e përmasave tepër të mëdha që të mund të konsiderohet si një shesh në krahasim me masat e tjera për t'u ndërmarrë të propozuara nga Zyra Qendrore.

Brenda veprave të projektuara gjatë periudhës kur Bosio ishte në krye të strukturës shqiptare vihet re një sekuencë e zhvillimit të gjuhës kompozicionale, që ndoshta nuk ka lidhje me ndërtimin planimetric të ndërtesave, i cili ndjek një parim funksional jo dhe aq rigoroz, por më tepër me fasadat e ndërtesave, sidomos në lidhje me marrëdhëniet me hapësirën publike. Elbasani dhe Vlora flasin gjuhë të ndryshme: i pari i butë dhe në përputhje me vendin, ndërsa i dyti monumental dhe romak i cili shfaq prirje të një *stili fascist* romak.

Një përmbledhje kompozicionale bëhet e mundur me realizimin e projektit të sheshit të Korçës¹⁷ me ndërtesën e re të Bashkisë, e cila sheh të lindin një sërë risish stileshe më të rafinuar nëse i krahasojmë me ndërhyrjet e bëra në projektet për ndërtesat e qyteteve të tjera që kemi parë deri më tani. Për fat të keq, nga ky projekt ka mbetur vetëm një vizatim, ku tregohet marrëdhëniet mes ndërtesës kryesore dhe sheshit si një sistem pushimi dhe qarkullimi.

Bosios dhe Zyra Qendrore arkitektët i lë mbresa të thella bukuria e arkitekturës tradicionale shqiptare, veçanërisht ajo që që ndikuar nga Perandoria Osmane, dhe në më shumë se një rast janë gjetur gjurmë të këtij respekti për kulturën lokale. Në fakt, shembull i kësaj dukurie janë katër harqet dhe kolonat ku është vendosur pjesa ballore e cila më parë kishte një planimetri rrethore e vendosur pranë mureve; është e qartë logjika me të cilën në Tiranë në të trija zgjidhjet e projektimit për sheshin Skënderbej njëra



Fig. 9. G. Bosio e Ufficio Centrale per l'Edilizia e l'Urbanistica albanese, Piazza centrale di Coritza, fotografia di disegno a lapis su lucido 1939 (Archivio Eredi Bosio, Firenze)

Fig. 9. G. Bosio dhe Zyra Qendrore për Ndërtimet dhe Urbanëstëkën shqiptare, Sheshi qendror i Korçës, fotografi e dizenos me lapis su lucido 1939 (Arkivi Eredi Bosio, Firenze)

gli edifici della altre città viste fin qui. Purtroppo di questo progetto rimane un solo disegno, in cui viene mostrata la relazione tra l'edificio principale e la piazza come sistema di sosta e di viabilità.

Bosio e gli architetti dell'Ufficio Centrale subiscono profondamente il fascino dell'architettura tradizionale albanese, soprattutto quella di influsso ottomano, ed in più di un'occasione se ne trovano tracce evidenti di rispetto della cultura locale. Ne sono prova infatti i quattro archi e colonne con

nga anët është xhamia ekzistuese; një shembull tjetër janë dy kullat e përmendura në projektin e katedrales së re të Vlorës; dhe në fund prova më e mirë është projekti për tregun qendror të qytetit të Beratit.

Tematika e markatës (tregut) është e një rëndësie të madhe për Bosion në përcaktimin e një praktike vepruese në lidhje me kulturën lokale të popujve të kolonive. Në Afrikë deshifrimi i karakterit tipologjik të hapësirave publike për



Fig. 10. G. Bosio e Ufficio Centrale per l'Edilizia e l'Urbanistica albanese, Piazza del mercato di Moggio, fotografia di disegno a lapis su lucido 1939 (Archivio Eredi Bosio, Firenze)

Fig. 9. G. Bosio dhe Zyra Qendrore për Ndërtimet dhe Urbanëstëkën shqiptare, Sheshi i tregut të Moggio-s, fotografi e dizenos me lapis su lucido. 1939 (Arkivi Eredi Bosio, Firenze)

cui viene impostato il fronte dell'edificio prossimo alla preesistenza a pianta circolare di Elbassan a ridosso delle mura; ne sono evidenti le logiche con cui a Tirana in tutte e tre le soluzioni di progetto per piazza Scanderbeg uno dei lati risulta essere la moschea esistente; ne sono ancora esempio le due torri accennate nel progetto della nuova cattedrale di Valona; ed infine ne è migliore verifica il progetto per il mercato centrale della città di Berat.

Il tema del mercato riveste per Bosio estrema importanza nella definizione di una prassi operativa rispetto alla cultura locale delle popolazioni coloniali. In Africa la decodifica dei caratteri tipologici dello spazio pubblico per il commercio indigeno stimola e suggerisce le forme del progetto di un nuovo mercato nel villaggio di Moggio¹⁸ il cui linguaggio compositivo è imitativo della condizione autoctona, mentre l'approccio planimetrico risente di una matrice distributiva profondamente razionale. In Albania, a Berat¹⁹, la proposta di un nuovo mercato diviene occasione di espressione di profondo rispetto per le consuetudini di vita sociale del piccolo centro urbano; l'uso di elementi architettonici di provenienza locale definisce, attraverso l'uso di arco e colonna simili a quelli usati nei disegni per Elbassan come per quanto fatto a Moggio, valori formali in parallelo con l'espressione locale; la planimetria invece risulta essere di stampo funzionale, distribuendo lo spazio attorno ad un sistema porticato che definisce una forma di piazza regolare. Come per le piazze monumentali di Valona, lo spazio-piazza tende a prevaricare i confini grazie all'uso di un colonnato che diviene filtro tra due ambienti aperti mettendoli in comunicazione; lo stesso tema si ritrova a Tirana nell'edificio della G.L.A. dove il portico di accesso pone in comunicazione la piazza del Littorio con lo stadio retrostante divenendone accesso. L'intervento progettato per Berat dimostra la maturità raggiunta dall'Ufficio Centrale, una maturità segnata dalla comprensione e dall'ascolto di quella metrica linguistica che le architetture locali esprimono, in alcuni episodi sommestamente, in altri con più forza, una maturità devoluta alla volontà ineludibile di creare una fusione tra le due culture che vada oltre il rapporto regime-colonie²⁰.

tregtinë vendase nxit dhe sugjeron formën e projektit të një tregu të ri në fshatin Moggio¹⁸ gjuha kompozicionale e të cilit imiton statusin autokton, ndërsa qasja planimetrike ndikohet nga një shpërndarje thellësisht racionale e ndërtesave. Në Shqipëri, në Berat¹⁹, propozimi për ndërtimin e një tregu të ri kthehet në një mundësi për të shprehur respektin e thellë për zakonet e jetës shoqërore të qendrës së vogël urbane; përdorimi i elementeve arkitektonike me origjinë vendase, përmes përdorimit të harkut dhe kolonave të ngjashme me ato që janë përdorur në vizatimet e Elbasanit si dhe në ato që janë bërë në Moggio, përcaktojnë vlerat formale të cilat shkojnë paralelisht me shprehjen e vlerave lokale; plani duket të jetë i llojit funksional, duke e shpërndarë hapësirën rreth një sistemi me portikë që i jep një formë të rregullt sheshit. Ashtu si për sheshet monumentale të Vlorës, hapësira-shesh priret t'i kapërcejë kufinj të falë përdorimit të një kolonade që kthehet në filtër mes dy ambienteve të hapura duke i lidhur ato me njëri-tjetrin; e njëjta temë gjendet në Tiranë në ndërtesën e PLSH-së ku portiku hyrës lidh sheshin e Liktorit me stadiumin në pjesën e pasme nga ku mund të hyhet. Ndërhyrja e planifikuar për në Berat tregon pjekurinë e arritur nga Zyra Qendrore, një maturi kjo e shenjuar nga të kuptuarit dhe nga të dëgjuarit e metrikës gjuhësore që shpreh arkitektura vendase, në disa vende më e fshehur e në disa të tjera më e dukshme, një pjekuri që i detyrohet dëshirës së pashmangshme për të krijuar një shkrirje mes dy kulturave që shkon përtej marrëdhënies sistem-koloni²⁰.

NOTE

¹ L'Ufficio Centrale per l'Edilizia e l'Urbanistica Albanese (da qui in avanti Ufficio Centrale) viene fondato da Gherardo Bosio che riceve incarico come da Decreto Luogotenenziale del Ministero degli Interni albanese (in accordo con il Sottosegretariato agli affari albanesi del Ministero degli Esteri italiano) n.122 del 12 Ottobre 1939 pubblicato su Gazzetta Ufficiale n.99 del 25 Ottobre 1939 datando l'inizio dell'incarico in forma retroattiva al 1 Luglio 1939 per la creazione e la direzione dell'Ufficio Centrale. (Rif.*Archivio Eredi Bosio* (da qui in avanti AEB) *Blocco Rosso Albania-Contratti 1_001-4_001*).

² Il periodo di funzionamento dell'Ufficio Centrale va dal 1939 al 1941 sotto la guida di Bosio; dal 1941 al 1943 i progetti vengono ultimati dai collaboratori. Poggi prende il ruolo di Bosio a partire dal 1 luglio 1941. Cfr. G. PALADINI, *Ricordi di un ufficio di urbanistica integrale*, in «Bollettino Tecnico» 10-11 (1954), Firenze.

³ I principali collaboratori dell'Ufficio Centrale sono: Giuseppe Paladini, con cui poi si creano tensioni nel momento in cui Bosio è in Italia; Ferrante Orzali e Ferdinando Poggi, Ivo Lambertini e Leone Carmignani. Cfr. PALADINI, *Ricordi di un ufficio di urbanistica integrale* ... cit.

⁴ L'importanza dell'organizzazione rivela anche un aspetto innovativo rispetto alla normale gestione di un apparato pubblico. Bosio infatti concepisce l'Ufficio Centrale come uno studio professionale, con un architetto a capo e con collaboratori più che come un ufficio pubblico; questa struttura risulta utile ad agevolare e sveltire quanto più possibile le procedure di lavoro. Bosio riceve in realtà molti incarichi diretti per i maggiori edifici e i piani regolatori che cura personalmente, a tal proposito si veda il regesto citato alla nota 12.

⁵ I disegni di Bosio per le architetture albanesi hanno molto risalto sulle riviste italiane. Per un regesto completo dei progetti pubblicati si veda R. RENZI, *Gherardo Bosio. Opera completa*, Firenze, 2016, pp. 354-367.

⁶ Bosio, già ufficiale di cavalleria, insiste per essere richiamato alle armi come volontario con destinazione Africa Orientale per tutta la seconda metà del 1935. Viene riarruolato il 16 Marzo 1936 per giungere a Massaua il 28 Aprile 1936 dove rimane fino al 18 dicembre 1936. (Rif.*AEB Blocco Blu-Arruolamento in AOI 5_010-5_011*). I progetti redatti in Africa sono: per il governo dell'Amara il Piano regolatore di Gondar (approvato con D.G. B.n 4 del 20 Agosto 1936) e di Dessiè (approvato con D.G. B.n 5 del 20 Ottobre 1936). Al rientro in Italia redige il Piano Regolatore di Gimma per il governo dei Galla Sidama (approvato con D.G. del 20 Ottobre 1937). Per il governo generale dell'Africa Orientale Italiana progetta il Centro Studi e il complesso per più edifici, tra cui gli uffici ed il museo minerario ad Addis Abeba nel 1936. Nei mesi di Marzo, Aprile e Maggio 1937 Bosio è di nuovo ad Addis Abeba per i lavori sulla residenza vicereale e del piccolo Ghebi. Negli anni 1937-38 inoltre riceve nuovi

SHËNIME

¹ Zyra Qendrore për Ndërtimet dhe Urbanistikën (nga këtu e më tej Zyra Qendrore) u themelua nga Gherardo Bosio që u ngarkua me detyrë nga Dekreti i Mëkëmbësit të Mbretit i Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë (në marrëveshje me nënsekretarin e Punëve të Shqipërisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme Italiane nr. 122 datë 12 tetor 1939 publikuar në Gazetën Zyrtare nr. 99 të 25 tetorit 1939 duke shënuar kështu fillimin e detyrës në mënyrë retroaktive nga 1 korriku 1939 për krijimin dhe drejtimin e Zyrës Qendrore. (Ref. *Archivi Eredi Bosio* (nga këtu e më tej AEB) *Blocco Rosso Albania-Contratti 1_001-4_001*).

² Periudha e funksionimit të Zyrës Qendrore fillon nga viti 1939 deri në vitin 1941 nën udhëheqjen e Bosio-s; nga viti 1941 deri në vitin 1943 projektet u plotësuan nga bashkëpunëtorët, Shih. G. PALADINI, *Ricordi di un ufficio di urbanistica integrale*, in «Bollettino Tecnico», 10-11 (1954), Firenze.

³ Bashkëpunëtorët kryesorë të Zyrës Qendrore janë: Giuseppe Paladini, me të cilin më pas u krijuan tensione gjatë kohë që Bosio është në Itali; Ferrante Orzali e Ferdinando Poggi, Ivo Lambertini e Leone Carmignani. Shih. PALADINI, *Ricordi di un ufficio di urbanistica integrale* ... cit.

⁴ Rëndësia e organizimit zbulon edhe një aspekt inovativ sa i përket drejtimit normal të një organizate publike. Bosio e konceptoi Zyrën Qendrore si një studio profesionale, me një arkitekt në krye të saj dhe me bashkëpunëtorë, më shumë sesa një zyrë publike. Kjo strukturë është e dobishme për të lehtësuar dhe shpejtuar sa më shumë të jetë e mundur procedurat e punës. Bosio në fakt merr shumë detyra të drejtpërdrejta për ndërtesa të mëdha dhe master-plane për të cilat kujdeset personalisht; shih përmbledhjen e cituar në shënimin 12.

⁵ Dizenjot e Bosio-s për arkitektuarat shqiptare patën mjaft rezultat në revistat italiane. Për një përmbledhje të plotë të projekteve të publikuara u kujdes R. RENZI, *Gherardo Bosio. Opera completa*, Firenze, 2016, fq. 354-367.

⁶ Bosio, tashmë oficer i kavalerisë, insiston që të thirret nga ushtria si vullnetar me destinacion Afrikën Lindore për gjysmën e dytë të vitit 1935. U fut në radhët e ushtrisë më 16 Mars 1936 për të mbërritur në Massaua më 28 Prill 1936 ku qëndron deri më 18 dhjetor 1936. (Ref. *AEB Blocco Blu-Arruolamento in AOI 5_010-5_011*). Projektet e hartuara në Afrikë: për Qeverinë e Amara-s, Plani Rregullator i Gondarit (miratuar me D.G. B.n 4 të 20 Gushtit 1936) dhe të Dessië (miratuar me D.G. B.n 5 të 20 tetor 1936). Me t'u rikthyer në Itali harton Planin Rregullator të Gimma-s për Qeverinë e Galla Sidama (miratuar me D.G. të 20 tetor 1937). Për Qeverinë e Përgjithshme të Afrikës Lindore italiane projektton Qendrën e Studimeve dhe kompleksin me shumë ndërtesa, ndër të cilat dhe zyrat dhe muzeun e minierave të Addis Abeba në vitin 1936. Në muajt mars, prill dhe maj 1937, Bosio shkon sërish në Addis Abeba për detyrat mbi rezidencën e Mëkëmbësit të Mbretit dhe të të

incarichi dai suddetti governi per la redazione ulteriore dei livelli esecutivi dei Piani Regolatori redatti. (*Rif.AEB Blocco Blu-Certificati Vari 1_004-1_005*). Per un profilo completo ed aggiornato grazie anche al lavoro dell'Arch.Marie Lou Busi nipote dell'architetto e custode dell'archivio (AEB), si veda *Il panorama dell'arredamento. Appunti per una serie di lezioni di Gherardo Bosio*, a cura di R. RENZI, Raleigh USA, 2012, pp.139 e sgg.

⁷ ... «Come una città in miniatura anche una casa ben studiata ha le sue vie (i percorsi seguiti nelle diverse funzioni della vita) e le sue piazze (i luoghi di riposo o di sosta o quelli di maggior traffico), la via è la spina dorsale della casa ed essa, pur non essendo indicata, deve quasi guidare il passo con l'attrattiva delle sue irregolarità, di repentini cambiamenti di direzione, della facilità dei passaggi e delle loro varietà, ottenuta con scalini, mezzi di illuminazione naturale e artificiale che creino giochi di luce e d'ombra in modo da non far percepire la lunghezza di essa...» Estratto da un ciclo di lezioni di Gherardo Bosio, 1932. Cfr. *Il panorama dell'arredamento* ... cit., pp. 120-125.

⁸ Cfr. G. PONTI, *Una villa alla pompeiana*, in «Domus», 79 (1934) e *Quartiere all'italiana*, in «Domus», 293 (1954).

⁹ Bosio partecipa nel 1937 al concorso per il Piano Regolatore di Rieti con il motto «P.25» insieme all'amico Ferdinando Poggi che poi chiamerà come collaboratore all'Ufficio Centrale. In questo progetto sono in luce tutti gli elementi, sia a livello urbani che a livello architettonico, delle esperienze africane e successive albanesi. (*Rif.AEB cartella 39*).

¹⁰ I progetti di Bosio vengono pubblicati, assieme anche a suoi testi, in molte riviste nazionali ed internazionali del tempo di cui si ricordano le principali: da «Casabella» a «Domus», da «Architettura» a «Illustrazione Italiana», da «Innen Dekoration» a «L'Architecture d'aujourd'hui». Di particolare rilievo risultano le pubblicazioni dei disegni per le città africane. Per un regesto completo dei progetti pubblicati si veda RENZI, *Gherardo Bosio*... cit., pp. 354-367.

¹¹ Il progetto per il nuovo centro di Harar è sviluppato insieme a Plinio Marconi e Guglielmo Ulrich nel 1938. (*Rif.AEB cartella 53*). Bosio ha incarico insieme agli altri due progettisti direttamente dal Governo dell'Harar, direzione affari generali con loro missiva del 29/7/1938 prot.9446. (*Rif.AEB Inserto verde-Governo dell'Harar 1_001-1_021*).

¹² Progetto e documenti con missiva di Ferdinando Poggi della prefazione del Piano Regolatore di Elbassan approvato nel 1943 con indicazione del lavoro eseguito da Bosio a partire dal 1939 (*Rif.AEB cartella 74-0*). Le fotografie ai disegni presenti in AEB sono alcune del 1942 e recano la firma di Ivo Lambertini, mancano quelle di Poggi. Per il regesto completo del lavoro di Bosio in Albania redatto dall'Ufficio Centrale nel 1940 e nel 1941 da Bosio stesso per il Ministero degli Esteri italiano (*Rif.AEB Blocco rosso/albania-promemoria 1_001-2_005*) da qui in poi si considera tale regesto anche per le note ed i progetti seguenti.

¹³ Progetti per la città di Valona sono in (*Rif.AEB cartella 76*) ed altri sono anche in forma di fotografie-estratti di una mostra tenutasi a Tirana nel 1940, sempre presenti in AEB.

voglit Ghebi. Në vitet 1937-38 ndër të tjera merr detyrë të reja nga qeveritë e sipërpërmendura për hartimin e mëtejshëm të niveleve zbatuese të Planeve Rregullatore të hartuara. (*Ref. AEB Blocco Blu-Certificati Vari 1_004-1_005*). Për një profil të plotë dhe të përditësuar falë edhe punës së Ark. Marie Lou Busi nip i arkitektit dhe ruajtës i arkivit (AEB), të shihet Riccardo Renzi (nën kujdesin e), *Il panorama dell'arredamento. Appunti per una serie di lezioni di Gherardo Bosio*, Raleigh USA, Lulu press inc., 2012, fq.139 e vijuese

⁷ ...«Si një qytet në miniaturë edhe një shtëpi e mirëstudjuar ka ka rrugët (rrugëtimet e saj të ndjekura në funksione të ndryshme të jetës) dhe sheshet e saj (vendet e pushimit dhe qendrimit ose ato me më shumë trafik), rruga është shtylla kurrizore e vetë shtëpisë dhe ajo, edhe pse nuk tregohet, duhet pothuajse të udhëheqë hapin me joshjen e parregullsive të saj, të ndryshimeve të vazhdueshme të drejtimeve, të thjeshtësisë së kalimeve dhe varieteteve të tyre, të përfuara me shkallë, mjete ndërimi natyral dhe artificial që krijojnë llojëra dritëhijesh në mënyrë që të mos perceptohet gjatësia e saj...» Ekstrakt i ciklit të leksioneve të Gherardo Bosio, 1932. Shih *Il panorama dell'arredamento* ... cit., fq. 120-125.

⁸ Shih. G. PONTI, *Una villa alla pompeiana*, në «Domus», 79 (1934) e *Quartiere all'italiana*, në «Domus», 293 (1954).

⁹ Bosio merr pjesë në vitin 1937 në konkursin për Planin Rregullator të Rietet me moton «P.25» së bashku me Ferdinando Poggi i cili më pas do ta thërrasë si bashkëpunëtor në Zyrën Qendrore. Në këtë projekt përfshihen të gjitha elementet si në rrafsh urban ashtu dhe arkitektonik, nga përvojat afrikane dhe ato pasuese shqiptare. (*Shih AEB kartela 39*).

¹⁰ Projektet e Bosio-s u publikuan së bashku me tekstet e tij në shumë revista kombëtare dhe ndërkombëtare të kohës ku mund të përmendim më kryesoret: «Casabella», «Domus», «Architettura», «Illustrazione Italiana», «Innen Dekoration», «L'Architecture d'aujourd'hui». Me rëndësi të veçantë rezultojnë botimet e dizenjove për qytetet afrikane. Për një konsultim më të plotë të projekteve të botuara shih RENZI, *Gherardo Bosio*... cit., fq. 354-367.

¹¹ Projekti për qendrën e re të Hararit është bërë së bashku me Plinio Marconi dhe Guglielmo Ulrich në vitin 1938. (*Ref. AEB kartela 53*). Bosio së bashku me dy projektuesit e tjerë është ngarkuar drejtpërdrejt nga qeveria e Hararit, drejtoria e punëve të përgjithshme me shkresë datë 29/7/1938 prot.nr. 9446. (*Ref. AEB Inserto verde-Governo dell'Harar 1_001-1_021*).

¹² Projekti dhe dokumenti me shkresë të Ferdinando Poggi i parathënies së Planit Rregullator të Elbasanit miratuar në vitin 1943 me shënime të punës së kryer nga Bosio duke filluar nga viti 1939 (*Ref.AEB kartela 74-0*). Fotografitë e dizenjove të pranishme në AEB janë disa të vitit 1942 dhe mbajnë firmën e Ivo Lambertini, mungojnë ato të Poggi-t. Për një konsultim të plotë të punës së Bosio-s në Shqipëri të hartuar nga Zyra Qendrore në vitin 1940 dhe 1941 nga vetë Bosio për Ministrinë e Jashtme italiane (*Ref.AEB Blocco rosso/albania-promemoria 1_001-2_005*) nga këtu e tutje merret në konsideratë edhe për shënimet dhe projektet vijuese.

¹⁴ Il progetto per la nuova sede del Ministero degli Esteri è redatto nel 1938 per la prima fase con il lotto disponibile tra piazza Capena, viale Aventino e via Baccelli a Roma. Bosio elabora tre soluzioni, di cui una a livello definitivo, che non consegnerà al concorso per evidenti impegni dovuti anche agli altri incarichi in corso (*Rif.AEB cartella 49*).

¹⁵ Relazione per il progetto del piano regolatore di Scutari è in (*Rif.AEB cartella 79-1*) mentre i disegni sono in forma di fotografie-estratti di una mostra tenutasi a Tirana nel 1940, sempre presenti in AEB.

¹⁶ Le architetture ed i progetti di Bosio risultano estremamente impegnate da un punto di vista sociale per tessere nuove maglie di vita collettiva piuttosto che separata tra cultura locale e presenza italiana.

¹⁷ Progetti per la città di Coritza sono in (*Rif.AEB cartella 79-0*) ed altri sono anche in forma di fotografie-estratti di una mostra tenutasi a Tirana nel 1940, sempre presenti in AEB.

¹⁸ Bosio sviluppa per la città africana di Moggio un progetto di massima per un insediamento residenziale inserito nel centro urbano ed un progetto di dettaglio per un mercato indigeno nel 1937/38 (*Rif.AEB cartella 44-2*).

¹⁹ I progetti per la piazza ed il mercato di Berat sono in (*Rif.AEB cartella 81*).

²⁰ Il materiale albanese presente in AEB riguarda i disegni che Bosio poteva portare a Firenze avendone incarico diretto, i disegni invece sviluppati a Tirana sono presenti in AEB sotto forma di fotografia degli originali.

¹³ Projektet për qytetin e Vlorës gjenden tek (*Ref.AEB kartela 76*) ndërsa të tjera janë edhe në formë fotografish të nxjerra nga ekspozita e mbajtur në Tiranë në vitin 1940, gjithë të pranishme tek AEB.

¹⁴ Projekti për selinë e re të Ministrisë së Jashtme është hartuar në vitin 1938 për fazën e parë të segmentit mes sheshit Capena, bulevardit Aventino dhe rrugës Baccelli në Roma. Bosio harton tre zgjidhje, nga ku njëra në nivel përfundimtar, të cilën nuk do ta dorëzojë në konkurs për shkak të angazhimeve të dukshme edhe me detyra të tjera në zhvillim e sipër. (*Ref.AEB kartela 49*).

¹⁵ Raporti për projektin e planit rregullator të Shkodrës gjendet tek (*Ref.AEB kartela 79-1*) ndërsa dizenjot janë në formë fotografish-ekstraktesh të një ekspozite të mbajtur në Tiranë në vitin 1940, gjithmonë të pranishme tek AEB.

¹⁶ Arkitekturat dhe projektet e Bosio-s rezultojnë jashtëzakonisht të angazhuara në një këndvështrim shoqëror për të krijuar struktura të reja të jetës kolektive dhe jo atë të asaj të ndarë mes kulturës lokale dhe pranisë italiane.

¹⁷ Projektet për qytetin e Korçës gjenden tek (*Ref.AEB kartela 79-0*) ndërsa disa të tjera janë edhe në formë fotografish-ekstraktesh të një ekspozite të mbajtur në Tiranë në vitin 1940, gjithmonë të pranishme tek AEB.

¹⁸ Bosio zhvillon për qytetin afrikan të Moggio-s një projekt në vija të përgjithshme për një vendbanim rezidencial të përfshirë në qendrën urbane dhe një projekt të detajuar për tregun indigen në vitin 1937/38 (*Ref.AEB kartela 44-2*).

¹⁹ Projektet për sheshin e tregut të Beratit gjenden tek (*Ref.AEB kartela 81*).

²⁰ Materiali shqiptar i pranishëm në AEB ka të bëjë me dizenjot e Bosio-s që mund të merrte me vete në FIRENCE duke qenë i ngarkuari i drejtëpërdrejtë ndërsa dizenjot e krijuar në Tiranë janë të pranishme tek AEB në formë fotografish të shkrepura tek origjinalet.

Finito di stampare in Italia nel mese di luglio 2017
da Pacini Editore Industrie Grafiche - Ospedaletto (Pisa)
per conto di Edifir-Edizioni Firenze